



Komuna e Shtimës

Zyra e Prokurimit

Nr. 03 / 01 / 083

Datë 08 / 12 / 2020

KONTRATË PËR FURNIZIM

Komuna Shtime Rr. „Tahir Sinani „, tel. 0290-389-016-131 ose 045-444-509 që e përfaqëson: Muhadin Halili , Drejtor i Prokurimit në njëren anë:

dhe

ARTA TEX GROUP SH.P.K., Faik Konica nr.17, 30000, Peje, Kosovë nga Peja që e përfaqëson Z.Arbër Mustafa nr. i tel.043-600-300 në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për:

Furnizim me Veshembathje –Faza dytë“

Nr i Prokurimit 617-20-7848-1-3-6

Nr i brendshëm 617-2020-104-136

Neni 1 Lënda

Lënda e kontratës do të jetë

Furnizim me Veshembathje –Faza dytë“

1.2 Kontrata hynë në fuqi me 08.12.2020 dhe përfundon me 21.12.2020

1.3 Afati kohor i performances nuk mund të jetë më shumë se 12 ditë nga data e marrjes së urdhëresës.

1.4 Vendi i dërgimit të furnizimeve do të jetë : *Institucionet e cekura në paramasë.*

1.5 Incotermi i aplikueshëm do të jetë DDP¹ (Detyra e Dërguar e Paguar).

Neni 2 Ligji i aplikueshëm

2.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092. Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë

Neni 3 Çmimi

**3.1 Çmimi total i kontratës do të jetë: 6,391.00 €
(Gjashtë mijë e treqindë e nëntëdhjetë e një euro)**

¹ DDP – Detyra e Dërguar e Paguar- Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Operatorit Ekonomik sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës (në përjashtim të çmimeve të atyre artikujve që i nënshtrohen ndryshimit të çmimit sipas berzës përkatëse, nëse aplikohet).

Neni 4 Pagesat

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro.

Autoriteti Kontraktues do të paguaj secilën shumë të detyrimeve pas pranimit të secilës dërgesë (Faturë) nga OE, dhe raporti i Menaxherit të Kontratës të caktuar nga AK për furnizimin e kryer .

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

Neni 6 Kualiteti

6.1 Kualiteti i *furnizimeve* duhet në të gjitha aspektet të plotësoj specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit.

Neni 7 Garancioni

7.1 Garancioni do të mbetet valid për NA

Neni 8 Vonesat në ekzekutim

8.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin [t'i dorëzojë ndonjë ose të gjitha mallrat] [të realizojë ndonjë ose të gjitha shërbimet] [të kryej ndonjë ose të gjitha punët] brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së *[furnizimeve]* të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

Neni 9 Inspektimi dhe testimi

9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtërinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

Neni 10 Nën-kontraktimi

10.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontrakttojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

Neni 11 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

11.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c). Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e). Falimenton; f). Është dënues nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res-judikata*; g) Operatori ekonomik i është

nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

Neni 12 Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik

12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorit Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 180 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

Neni 13 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

13.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.

13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në *gjykatën kompetente* në pajtim me ligjin e Kosovës.



Neni 14 Komunikimi

14.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin e identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.

E hartuar në gjuhën *Shqipe* në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Operatorin Ekonomik.

Për Operatorin Ekonomik

Për Autoritetin Kontraktues

Emri:	Arber Mustafa	Emri:	Muhadin Halili
Pozita:	Pronar	Pozita:	Drejtor i Prokurimit
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	08.12.2020	Data:	08.12.2020
Vula:		Vula:	




Specifikacion:Furnizim me Veshembathje-Faza Dytë-QKMF-ja

Ir	Përshkrimi	nj.matëse	sasia	çmimi	shuma
1	Mantila për mjek dhe infermier (medical ose ekuivalent)	Copë	79	9.00	711.00
2	Uniformë për Mjek dhe infermier: komplet (pantolla ,bluze) , Materiali kualitativ 35% cotton (medical ose ekuivalent)	Komplete	79	18.00	1422.00
3	Uniformë për vozitësit e autoambulancës - Komplet (pantolla ,bluzë ,jelek ,jakne)	Komplete	6	49.00	294.00
4	Uniformë për puntorët e sigurimit - Komplet (pantolla, bluza,jelek, jakne ,)	Komplete	4	46.00	184.00
5	Uniformë për puntorë të hixhienës : komplet , (pantolla,bluza), Materiali kualitativ	Komplete	4	18.00	72.00
6	Klompe (Leon ose ekuivalent)	Palë	79	12.00	948.00
7	Këpucë	Palë	9	24.00	216.00
Totali:					3847.00

PS: Uniformat të shenjohen me logon e QKMF" Dr Vezir Bajrami,, Shtime.Pas kontraktimit operatori furnizues të kontaktojë menagjmentin e QKMF së për : ngjyrat,formen,dhe numrat e uniformave dhe mbathjeve.

Specifikacion:Furnizim me Veshembathje-Faza Dytë-IP'Albiona Asllani'Shtime


Nr	Pershkrimi	Nj matse	Sasia	Cmimi ME TVSH	Shuma ME TVSH
1	Uniforma per edukatoret- mantil, maice dhe pantolla si ne foto (ngjyra e percaktohet nga I.P, materiali qe hekuroset lehte dhe qe lahet ne 90° C) Madhesia percaktohet ne bashkepunim me institucionin dhe detajet tjera	Copë	40	20.00 €	800.00 €

2	Uniforma per kuzhinieret komplet (si ne foto)(ngjyra e percaktohet nga I.P, materiali qe hekuroset lehte dhe qe lahet ne 90° C) Madhesia percaktohet ne bashkepunim me institucionin dhe detajet tjera		Komplete	8	20.00 €	160.00 €
3	Uniforma per higjienistet- si ne foto (materiali qe hekuroset lehte dhe qe lahet ne 90° C) Madhesia percaktohet ne bashkepunim me institucionin dhe detajet tjera		Komplete	8	18.00 €	144.00 €
4	Uniforma per punetor teknik (si ne foto, madhesia ne konsultim me institucionin)		Komplete	4	20.00 €	80.00 €
5	Kilompe te bardha kualitet (numrat vendosen ne marreveshje me institucionin)		Palë	20	12.00 €	240.00 €
6	Qarqafe komplet per femije materiali 100% pambuk (dimensioni 1. 20 x 0. 80) me figura per femije baza e bardhe qe lahet ne 90°C dhe qe hekurosen lehte) 100 cope per vajza		Komplete	100	4.50 €	450.00 €
7	Qarqafe komplet per femije materiali 100% pambuk (dimensioni 1. 20 x 0. 80) me figura per femije baza e bardhe qe lahet ne 90°C dhe qe hekurosen lehte) 100 cope per djem		Komplete	100	4.50 €	450.00 €
8	Peshqira te bardhe materiali kualitet (si ne foto te cilet lahen ne 90°C) 70x50cm		Copë	100	1.50 €	150.00 €
9	Peqeta gotash kualitet 100% pambuk (70x50cm)		Copë	50	1.00 €	50.00 €
10	Lecka per pastrim (70x50 cm)		Copë	20	1.00 €	20.00 €
Totali:						2544.00

Vërejtje: Operatori ekonomik i cili shpërblehet me kontratë, për të gjitha specifikat e paisjeve në këtë specifikacion duhet të konsultohet paraprakisht gjatë furnizimit me drejtorin e institucionit dhe meaxherin e kontratës deri të kryhet i tërë furnizimi.

REKAPITULIM

Nr	Pozicioni	Çmimi
----	-----------	-------



1	Furnizim me Veshembathje-Faza Dytë-QKMF-ja	3847.00
2	Furnizim me Veshembathje-Faza Dytë-IP' Albiona Asllani'Shtime	2544.00
	Gjithsejt Totali	6391.00

Emri i Kompanisë	ARTA TEX GROUP SHPK Rr. Faik Konica - PEJE
Adresa e Plote	
Përfaqësuar Nga:	ARMEND MUSTAFA
Emri & Mbiemri	DREJTOR
Pozita	
Nënshkrimi	27.11.2020
Data	
Vula	

